

C.nr.126/2015

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, gjyqtari Burim Emërllahu, në çështjen juridike të paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaji, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson [REDAKTUAR], kundër të paditurës Telekom i Kosovës SH.A| në Prishtinë, të cilën e përfaqëson [REDAKTUAR] baza juridike pagesa e të ardhurave personale, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë më datë 05.01.2017, bie këtë:

### A K T G J Y K I M

**I. PJESERISHTË APROVOHET SI E BAZUAR** kërkesëpadija e paditësit [REDAKTUAR] dhe **DETYROHET** e paditura Telekom i Kosovës SH.A Prishtinë, që paditësit [REDAKTUAR], t'ia paguajë shumën e të hollave prej 5701.77, me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data 01.01.2017 deri në pagesën definitive, si dhe anulohet aktvendimi nr.01/1040-1107/2012, i datës 07.03.2012.

**II.** Detyrohet e paditura Telekom i Kosovës SH.A Prishtinë që paditësi [REDAKTUAR] në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguaj shumën e të hollave prej 120 euro, ndërsa refuzohet si e pabazuar kërkesa e të autorizuarit të paditësit me të cilën i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore për taksën për aktgjykim.

**III. REFUZOHET SI E PA BAZUAR** pjesa e kërkesëpadiisë së paditësit [REDAKTUAR] me të cilin ka kërkuar që të detyrohet e paditura Telekom i Kosovës Sh.A në Prishtinë që paditësit [REDAKTUAR] të ia paguajë shumën e të hollave prej 1758.84 euro, me kamatë prej 8% në vit, duke fillu nga data 01.01.2017 e deri në pagesën definitive, si dhe refuzohet si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadiisë së paditësit [REDAKTUAR] me të cilin ka kërkuar që ti kthehet grada nga 10 në 11, nga dita e plotëfuqieshmërisë së aktgjykimit.

**IV.** Detyrohet paditësi [REDAKTUAR] që kësaj gjykate në emër të taksës gjyqësore për aktgjykim t'ia paguaj shumën e të hollave prej 50 euro.

### A r s y e t i m

Paditësi [REDAKTUAR] në këtë gjykatë, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A në Prishtinë, tani me emërtimin Telekom i Kosovës.

Paditësi në padi ka theksuar: Paditësi ka lidhë me të paditurin kontratën e punës e cila është protokolluar me nr.01-2880-1/2011, të datës 20.10.2011. Në nenin 5 të kësaj kontrate parashihet që paditësi për punën e kryer të kompensohet me pagë të përcaktuar nga grada 11, kurse me vendimin e burimeve njerëzore nr.01-1040-1107/2012 të datës 07.03.2012 paditësi i caktohet grada 10. Paditësi në afatin e paraparë në nenin 87, 78, 79 të ligjit të punës ka iniciuar procedurat e duhura për të plotësuar kushtet për iniciimin e procedurës gjyqësore me padi në gjykatë, duke paraqitur kërkesë për kthimin e gradës dhe ankesë kundër vendimit nr.01-1040-1107/2012 të

datës 07.03.2012. E paditura , nuk është përgjigjur në email, kërkesën dhe ankesën e paditësit. Paditësi është dëmtuar në mënyrë të kundërligjeshme në page në shumën rreth 100 euro për qdo muaj duke filluar nga paga e muajit shkurt te vitit 2012 si dhe në muajt në vazhdim edhe për shkak të zvoglimit të kontributeve në trust, në lartësinë prej 77 euro për qdo muaj, duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2012 si dhe në muajt në vazhdim. Duke u bazuar në faktet e parashtruara më lart, për shkak të shkeljes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit me vendim arbitrar, të marrë me aktvendim nr.01-1040-1107/2012 të datës 07.03.2012, në afatin e paraparë në nenin 87 dhe nenin 79 të ligjit të punës, paditësi ka paditë PTK-në.

Përfaqësuesi i paditësit [REDAKTUAR] ka kërkuar nga Gjykata që ta detyrojë të paditurën Telekom i Kosovës që paditësit të ja paguajë shumën prej 7460.61euro, me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data 01.01.2017 deri në pagesën definitive. Si dhe ka kërkuar nga Gjykata ta anulojë aktvendimin nr.01/1040-1107/2012, i datës 07.03.2012 dhe paditësit nga dita e plotëfuqieshmërisë së aktgjykimit ti kthehet grada nga 10 në 11. Po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura përmesë përfaqësueses së saj [REDAKTUAR] ka theksuar e kontestoj bazën ligjore të padisë dhe kërkesëpadisë nga se e njejta është e pabazuar, ashtu që i propozojë Gjykatës që të nxjerrë aktgjykim me të cilin do të refuzojë si të pabazuarë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit.

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe sa më të plotë të gjendjes faktike në këtë qështje civilo-juridike gjatë shqyrtimit gjyqësorë janë administruarë si provë: aktvendimi nr. 01/1040-1107/2012 i datës 07.03.2012, kontrata e punës e vitit 2011, kontrata e punës e datës 02.09.2015, ekspertiza e ekspertit financiar [REDAKTUAR] ankesa e datës 12.02.2015, kërkesa e datës 22.01.2015.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara deklarave të palëve ndërgjyqjese, fakteve jo kontestuese ndërmjetë tyre vërtetojë këtë gjendje faktike: ndërmjet palëve nuk ishte kontestuese egzistimi i faktit se e paditura me vendimin 07.03.2012 nr.01/1040-1107/2012 ja ka ulur paditësit gradën nga grada 11 në gradën 10 duke filluar nga data 01.02.2012, i cili fakt vërtetohet edhe nga vendimi i sipër përmendur.

Me leximin e kontratës së punës 20.10.2011 Gjykata ka vërtetuarë se me nenin. 5 të kësaj kontrate ishte paraparë se paditësit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin, në lartësi të gradës 11.

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit financiar z. [REDAKTUAR], Gjykata ka vërtetuarë se lartësia e të ardhurave personale të perealizuara nga paditësi për periudhën kohore nga 01.02.2012 e deri më datë 31.08.2015, që ka qenë pasojë e zbritjes së gradës nga 11 në 10 është 5100.54 euro kurse lartësia e kamatës e llogaritur në atë shumë është gjithësej 601.23euro deri më date 31.12.2016.

Gjykata duke u bazuarë në gjendjen faktike të shpjeguarë si me lartë ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sepse veprimi i të paditurës me të cilin i'a ka ulur gradën



paditësit ,gjatë kohës sa ka qenë fuqi kontrata e sipër përmendur e datës 20.10.2011 është në kundërshtim me nenin 55 par. 1 të Ligjit të punës (Gazeta zyrtare 03-L-212 -te RK) ku është përcaktuar se i punësuar ka të drejtë në pagë e cila caktohet me kontratë të punës e në pajtim me këtë Ligj, kontratën, kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit sipas kontratës së punës së datës 20.11.2011 ka qenë në graden 11 dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës së datës 20.11.2011 sa e njehta ka qenë në fuqi dhe ligjit".Kurse nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit financiar është vërtetuar se lartësia e të ardhurave personale të përealizuara nga paditësi për periudhën kohore nga 01.02.2012 e deri më datë 31.08.2015, që ka qenë pasojë e zbritjes së gradës nga 11 në 10 është 5100.54 euro kurse lartësia e kamatës e llogaritur në atë shumë është gjithësej 601.23 euro deri më datë 31.12.2016.

Gjykata e ka refuzuar pjesën e kërkesepadise së paditësit si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi sepse me leximin e kontratës së punës të datës 02.09.2015 gjykata ka vërtetuar se paditësi ka lidhë këtë kontratë të punës me të padituren dhe me nenin. 5 të kësaj kontrate ishte paraparë se paditësit i caktohet paga bazë për punën të cilën kryen për punëdhënësin, në lartësi të gradës 10 prandaj paditësi gjerë sa të jetë në fuqi kjo kontratë në bazë të nenit 55 të ligjit të punës ka të drejtë të realizojë të ardhurat personale të parapara me këtë kontratë dhe Gjykata me vendimet e saja nuk mundet të ndryshojë kontratat e punës sepse kontrata është akt i palëve e jo i Gjykatës.Nga përmbajtja e kontratës së datës 02.09.2015,rezulton se e njehta është në fuqi nga data 01.09.2015.

Gjykata duke u bazuar në nenet 452.3,454.1 të LPK-së ,e ka detyruara palën e paditur që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore për ekspertizën financiare ,për taksën për padi në vlerë prej 120 euro.

Kurse gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës paditëse me të cilën i ka kërkuar shpenzimet për taksën për aktgjykim,sepse pala paditëse nuk i ka prezantuar provë gjykatës për të vërtetuar faktin se ka bërë shpenzime për taksën për aktgjykim.

Vendimi për taksë gjyqësore për aktgjykim si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi është bazuar në udhëzimin administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

Me datë 05.01.2017

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM - *Ac nr.*  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC *814/17*

Gjyqtari

Më *28.03* 20 *18*  
Dana

*Burim Emerllahu*



**EDHEZIMI I MËJETIN JURIDIK** : kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi përmes të kësaj gjykate.

Republika e Kosovës  Republika Kosovo

VENDIMI ËSHTË I EKZEKUTUESHËM  
ODLUKA JE IZVRŠNA

Më dt. *15.10.2017*  
Dana

Punëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik

